



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 129

Tiranë – E mërkurë, 28 shtator 2022

PËRMBAJTJA

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 621, datë 28.9.2022

Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.....

Faqe

16165

**VENDIM****Nr. 621, datë 28.9.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR.187, DATË 8.3.2017, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE
CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA
INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1/3 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “a”:

i. Shtohet emërtesa “Instituti i Shëndetit Publik”;

ii. Shfuqizohet emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit”.

b) Në shkronjën “b” shtohet emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë”.

2. Pika 4/2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/2. Në Kryeministri:

a) në masën 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet:

i. “Drejtor departamenti” dhe “Drejtor njësie”, në departamentin përgjegjës për çështjet rregullatore dhe përputhshmërinë dhe departamentin përgjegjës për politikën dhe mirëqeverisjen;

ii. “Drejtor drejtorie”, në departamentin përgjegjës për politikën dhe mirëqeverisjen;

b) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet “Jurist” dhe “Koordinator”, në njësitë përgjegjëse për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave, programimin e akteve rregullatore dhe RIA, si dhe njësinë përgjegjëse për koordinimin e nismave prioritare dhe të Acquis, në departamentin përgjegjës për çështjet rregullatore dhe përputhshmërinë;

c) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet “Koordinator”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në departamentin përgjegjës për politikën dhe mirëqeverisjen;

ç) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet:

i. “Drejtor departamenti”, në departamentin përgjegjës për administrimin;

ii. “Drejtor njësie”, në njësinë përgjegjëse për buxhetin dhe administrimin;

iii. “Koordinator”, në njësinë e menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm;

iv. “Drejtor drejtorie” dhe “Koordinator” në drejtorinë përgjegjëse për koordinimin teknik, në departamentin përgjegjës për çështjet rregullatore dhe përputhshmërinë;

v. “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në departamentin përgjegjës për çështjet rregullatore dhe përputhshmërinë.”.

3. Pika 4/3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/3. Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nëpunësi në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, dhe nëpunësit në pozicionet “Inspektor i Lartë” dhe “Ndihmësinsektor i Lartë”, në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.”.

4. Pika 4/12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/12. Në ministrinë përgjegjëse për financat:

a) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj, për nëpunësin në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”;

b) në masën 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “Drejtor i përgjithshëm”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për çështjet e makroekonomisë, në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për politikën fiskale, dhe në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për borxhin;



c) në masën 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “Drejtor drejtorie” në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror dhe vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për çështjet e makroekonomisë, në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për politikat fiskale, në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për borxhin, dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator;

ç) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet:

i. “Koordinator”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror dhe vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;

ii. “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për çështjet e makroekonomisë, në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse borxhin, në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për politikat fiskale, dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator;

d) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit dhe funksionarët në pozicionet “Drejtor i kabinetit të ministrit”, “Këshilltar”, “Drejtor i Përgjithshëm”, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në njësitë e tjera teknike të përmbajtjes.”.

5. Pika 4/13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/13. Në Ministrinë e Drejtësisë:

a) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj, për nëpunësin në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”;

b) në masën 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në muaj, për nëpunësin në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm”, në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit, dhe për nëpunësit në pozicionet “Drejtor drejtorie”, në drejtorinë e përgjithshme,

përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit;

c) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “Përgjegjës sektori”, “Koordinator” dhe “Specialist”, në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit.”.

6. Pika 4/15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/15. Në Departamentin e Administratës Publike:

a) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj, për nëpunësin në pozicionin “Drejtor departamenti”;

b) në masën 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “Drejtor njësie” dhe “Drejtor drejtorie” të njësive teknike të përmbajtjes;

c) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “Përgjegjës sektori”, “Koordinator” dhe “Specialist” të njësive teknike të përmbajtjes.”.

7. Pas pikës 4/21 shtohet pika 4/22, me këtë përmbajtje:

“4/22. Në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, nëpunësit në pozicionet “drejtor i përgjithshëm”, “Drejtor drejtorie”, “Koordinator”, “Analist”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në drejtoritë dhe sektorët teknike të përmbajtjes, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.”.

8. Pas pikës 9/17 shtohet pika 9/18, me këtë përmbajtje:

“9/18. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të nëpunësve pa tituj akademikë në pozicionet e punës “specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Institutin e Shëndetit Publik, janë sipas lidhjes nr.6/18, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

9. Lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtën numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Në lidhjen nr.3 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Rreshti i tretë ndryshohet, si më poshtë vijon:

Ministria e Drejtësisë	Koordinator në drejtorinë e përgjithshme, përgjegjëse për kodifikimin dhe harmonizimin e legjislacionit	III-a/1		
------------------------	---	---------	--	--



b) Në fund të lidhjes shtohet rreshti, me këtë përmbajtje:

Ministria përgjegjëse për financat	Koordinator në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror dhe vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit	III-a/1
--	--	---------

11. Në lidhjen nr.3/2 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas rreshtit të dytë shtohet rreshti, me këtë përmbajtje:

Drejtor njësie.	II-a	1
-----------------	------	---

b) Pas rreshtit të katërt shtohet rreshti, me këtë përmbajtje:

Koordinator në njësitë teknike të përmbajtjes	III-a/1	1
---	---------	---

12. Në lidhjen nr.5/6, pas emërtesës “Përgjegjës sektori në njësitë mbështetëse” shtohet emërtesa “Koordinator”.

13. Në lidhjen nr.6, pas emërtesës “Përgjegjës departamenti në Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore” shtohet emërtesa “Menaxher cilësie në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit”.

14. Në lidhjen nr.7, emërtesa “Menaxher cilësie në drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit”, shfuqizohet.

15. Pjesët I dhe III, të lidhjes nr.7/1, zëvendësohen me pjesët I dhe III, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

16. Lidhja nr.7/3 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

17. Lidhja nr.8/2 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

18. Në lidhjen nr.9, pas emërtesës “Specialist në institucionet rajonale” shtohet emërtesa “Specialist në zyrat vendore të punësimit”.

II. Pika 2.2; në pikën 3, fjalët “... kolona 3 e lidhjes nr.6, ...”; në pikën 6, fjalët “... të lidhjes nr. 6”; në pikën 7, fjalët “... lidhjes nr.6, ...”; pika 12/4 dhe lidhja nr.6, të vendimit nr.555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me

arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Siptalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar, shfuqizohen.

III. Efektet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e lira si pasojë e vakancave në strukturat e institucioneve, si dhe nga fondet e miratuara me aktin normativ nr.12, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar”, në kuadër të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës dhe i shtrin efektet financiare:

a) për përcaktimin në pikën 12, të ndarjes I, të këtij vendimi, dhe riklasifikimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë nga momenti i transferimit, emërimit apo lirimit të nëpunësve;

b) për të gjitha parashikimet e tjera nga data 1 shtator 2022.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Lidhja nr. 1

Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV), në përqindje	Shtesa për Kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për Pozicion (SHP) lekë
I	I-a		2%		150.500
	I-b		2%		138.700
II	II-a		2%		126.300
	II-b		2%		107.000
III	III-a		2%	0	86.500
	III-a/1		2%	0	74.800
	III-b		2%	0	65.200
IV	IV-a		2%	0	52.000
	IV-b		2%	0	40.600
	IV-c		2%	0	31.500

Lidhja nr. 6/18

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të nëpunësve pa tituj akademikë në pozicionet e punës “specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Institutin e Shëndetit Publik

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESË PËR KUSHTE PUNE
Titullar insitucioni	II-a	1	10.000
Zëvendësitualltar ekonomik. Drejtor i drejtorisë së shërbimeve mbështetëse.	III-a	1	0
Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes nga Rrezatimet.	III-a	1	15.000
Përgjegjës sektori në njësitë e tjera të përmbytjes pa tituj e grada.	III-a/1	1	0
Përgjegjës sektori në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Rrezatimet.	III-a/1	1	15.000
Përgjegjës sektori mbështetës.	III-b	1	0
Specialist në njësitë e përmbytjes pa tituj e grada.	III-b	1 ose 2	0



Specialist në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Rrezatimet.	III-b	1 ose 2	15.000
Specialist në sektorët mbështetës.	IV-b	1 ose 2 ose 3	0

I- Për Teatrin Kombëtar

Nr	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Regjisor. Aktor i parë.	90.600
2	Asistent regjisor. Aktor i dytë.	81.300
3	Skenograf i kategorisë së parë.	68.500
4	Aktor i tretë.	66.500
5	Skenograf i kategorisë së dytë.	56.700

III- Për trupën artistike të Teatrit të Kukullave, në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Cirkun Kombëtar

Nr	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Dirigjent. Regjisor. Drejtues artistik.	81.300
2	Skenograf i kategorisë së parë. Mjeshtër i studios së cirkut. Mjeshtër profili i numrave të cirkut. Aktor i parë. Akrobat i kategorisë së parë.	68.500
3	Aktor i dytë. Skenograf i kategorisë së dytë. Akrobat i kategorisë së dytë.	56.700

Lidhja nr. 7/3

Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe trupën artistike në Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

Nr	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Udhëheqës Artistik.	90.600
2	Dirigjent. Regjisor.	81.300
3	Instrumentist. Vokalist.	68.500

Lidhja nr. 8/2

Pagat dhe shtesat mbi pagë për pozicionet e punës në Sektorin e Helikopterëve të Repartit Special Renea

POZICIONI	VLERA E PAGËS (LEKË)	SHTESA PËR KUSHTE PUNE (LEKË)
Shef i sektorit. Pilot. Teknik fluturues.	80.900	40.000

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë